

DEKRIMINALIZIMI I DROGAVE
SI BAZË PËR POLITIKË **HUMANE**
DHE TË EFEKTSHME PËR DROGAT



ANALIZË E MODELIT PORTUGEZ DHE
HOLANDEZ TË DEKRIMINALIZIMIT

DOKUMENTI PËR POLITIKA PUBLIKE

VLATKO DEKOV



Botues:

Koalicioni "Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara" MARGJINAT – Shkup

Autor:

Vlatko Dekov

Lektura:

Violeta Tançeva-Zllateva

Përktheu:

Gramoz Shabani

Dizajni:

Bojana Micevska

Tirazhi 40

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

613.83

343.575

DEKOV, Vlatko

Dekriminalizmi i drogave si bazë për politikë humane dhe të efektshme për drogat : analizë e modelit portugez dhe holandes të dekriminalizmit : dokumenti për politika publike / Vlatko Dekov ; [përktheu Gramoz Shabani]. - Shkup : Koalicioni Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara, 2020. - 22 стр. : илустр. ; 30 см

Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. [22]

ISBN 978-608-4803-28-7

а) Дроги -- Декриминализација -- Придобивки -- Истражувања

COBISS.MK-ID 52752133



Ky publikim është botuar në suaza të projektit "Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të bashkësive të marginalizuara", të mbështetur nga Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni.

DEKRIMINALIZIMI I DROGAVE
SI BAZË PËR POLITIKË **HUMANE**
DHE TË EFEKTSHME PËR DROGAT



HYRJE

Gjatë dekadave të fundit vazhdimisht rritet përdorimi i drogave në gjithë botën, edhe krahas politikave restriktive të ndalesës. Kjo qasje tradicionale e ndalesës dhe dënimit për shkak të posedimit dhe përdorimit të drogave krijon padrejtësi sociale në nivel individual, probleme publike-shëndetësore dhe shpenzime të larta sociale në mikro nivelin. Republika e Maqedonisë së Veriut nuk devijon nga kjo mënyrë e trajtimit të çështjes për përdorimin e drogave. Në të vërtetë, me Kodin penal ndalohet organizimi, prodhimi, përpunimi dhe shitja e drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorët.¹Gjithashtu ndalohet posedimi i drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorëve me qëllim të shitjes së mëtejshme, transportimit ose ndërmjetësimit në shitje. Dispozitat nuk e ndalojnë posedimin për përdorim personal, por është vendosur praktikë e rëndësishme e institucioneve, si për shembull, e Ministrisë për Punë të Brendshme, Prokurorisë Publike dhe gjykatave, përmes së cilës shpesh personat e dënuar për posedim të substancave të palejuara, janë po ata persona të cilët substancën e kanë poseduar për përdorim personal (Boshkova, Tupançevski 2014).

Ky qëndrim i sistemit penal-juridik ndaj njerëzve të cilët përdorin droga ndikon mbi marginalizimin e tyre shtesë, shkeljen e të drejtave të tyre dhe kufizimin e mundësisë që të kenë mbrojtje adekuate të drejtave para institucioneve kompetente. Dokumentet dhe aktivitetet tjera me të cilat zbatohet politika për drogat në nivel kombëtar nuk janë të vazhdueshme (të bazuara në projekte) dhe të paqëndrueshme, me çka krijohet kaos në zbatimin e tyre dhe efektet nga ajo. Për shembull, Strategjia kombëtare për drogat² 2014 – 2020 nuk e parashih legalizimin e kanabisit për qëllime mjekësore, por kjo është bërë me vendim politik, dhe nuk është zbatuar përcaktimi i sasive minimale të drogave për përdorim personal, të planifikuar me Strategjinë kombëtare për drogat 2006 – 2012.³

Qëllimi i kësaj mase ishte të respektohen të drejtat e njerëzve të cilët përdorin droga, mos të privohen nga liria për shkak të posedimit të cilësdo drogë për përdorim personal dhe të ulen shpenzimet lidhur me aksionet policore dhe proceset gjyqësore. Përkundrazi, praktika e privimit nga liria e personave të cilët posedojnë droga për përdorim personal dhe dënimi i tyre vazhdon të zbatohet deri në ditën e sotme.

1 “Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 37/96; 80/99; 04/02; 43/03; 19/04; 81/05; 60/06; 07/08; 139/08; 114/09; 51/11; 135/11; 185/1. Kodi penal, neni 215.

2 Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Strategjia kombëtare për drogat 2014 – 2020.

3 Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Strategjia kombëtare për drogat 2006 – 2012.

Shumë shtete në botë kanë vendosur për aplikimin e zgjidhjeve të reja, gjegjësisht të krijojnë modele të veta për dekriminalizimin e të gjitha llojeve të drogave, si Portugalia, ose vetëm për disa prej tyre, si Holanda, Uruguai etj. Në këtë dokument i rishikojmë politikat për dekriminalizimin e drogave të cilat zbatohen në Portugali dhe Holandë. Këto modele janë bazë për identifikimin e propozim-zgjidhjeve për avancimin e politikave dhe praktikës së institucioneve përkatëse ndaj personave të cilët përdorin droga në Republikën e Maqedonisë së Veriut, dhe të cilat nuk janë kufizuar me heqjen e ndjekjes penale-juridike, por japin perspektivë më të gjerë për reforma të sistemit të përgjithshëm lidhur me drogat.

ÇFARË ËSHTË DEKRIMINALIZIMI?

Dekriminalizimi i drogave shpesh definohet si heqja e veprave penale lidhur me posedimin dhe përdorimin e drogave, më rrallë edhe për blerjen e drogave (EMCDDA 2018a).

Dekriminalizimi paraqet zhvendosjen e fokusit të politikave nga sistemi policor-gjyqësor drejt sistemit shëndetësor-social. Korniza e tillë krijon kontekst dhe mjedis për mbështetje për intervenimet publike-shëndetësore dhe sociale për personat të cilët përdorin droga dhe minimizimi i pasojave negative nga ndjekja penale për shkak të posedimit dhe përdorimit të drogave (Benfer et al. 2018, International Drug Policy Consortium 2016).

Varësisht nga qëllimi që shteti dëshiron ta arrijë, shpesh nuk mjafton vetëm të dekriminalizohet posedimi dhe/ose përdorimi i drogave, por ka nevojë për miratimin e masave tjera (Unlu et al. 2020). Për shembull, nëse qëllimi është të zvogëlohet numri i HIV-infektiveve dhe numri i rasteve të vdekshmërisë me mbidozë, atëherë nuk mjafton vetëm masa për ndryshimin e dispozitave në Ligj, me të cilin dekriminalizohet posedimi i drogave dhe përdorimi i tyre. Krahas kësaj, ka nevojë që të zhvillohen dhe hapen më shumë programe për zvogëlimin e dëmeve nga përdorimi i drogave, si për shembull, shkëmbimi i pajisjes sterile për injektim dhe distribuimi i naloksonit. Prandaj, gjithmonë dekriminalizimi i drogave duhet të jetë pjesë e një modeli ose strategjie më të gjerë për zgjidhjen e problemeve lidhur me drogat dhe varësitë lidhur me ato.

CILAT JANË PËRFITIMET NGA POLITIKAT PËR DEKRIMINALIZIMIN E DROGAVE?

Hulumtime dhe analiza të shumta kanë dëshmuar se dekriminalizimi sjell deri te zvogëlimi i rreziqeve shëndetësore, rasteve të vdekshmërisë dhe shpenzimeve financiare të shkaktuara nga politikat restriktive të ndalesës. Analiza jonë e modeleve për dekriminalizim në Portugali dhe Holandë dëshmon se:

- Politikat për dekriminalizim të drogave i respektojnë të drejtat e njeriut të personave të cilët përdorin droga më shumë se sa politikat që e kriminalizojnë përdorimin dhe/ose posedimin e drogave për përdorim personal.
- Politikat sociale në shtetet me politikë të dekriminalizimit të drogave sigurojnë qasje deri te një vëllim i gjerë i përfitimesh dhe shërbimesh për personat të cilët përdorin droga, me çka përmirësohet përfshirja e tyre sociale, si dhe punësimi.
- Politikat për dekriminalizim të drogave e rritin qasjen deri te programet për mjekim dhe risocializim të personave të cilët përdorin droga.
- Politikat për dekriminalizim të drogave bashkë me programet adekuate shëndetësore dhe sociale ndikojnë për zvogëlimin e prevalencës së HIV/AIDS dhe të infektimeve seksualisht të transmetueshme dhe përmes gjakut, mes personave të cilët përdorin droga.
- Politikat për dekriminalizim të drogave sjelli deri te zvogëlimi i vdekshmërisë lidhur me përdorimin e drogave.
- Politikat për dekriminalizim të drogave e zvogëlojnë stigmën dhe diskriminimin ndaj personave të cilët përdorin droga.
- Politikat për dekriminalizim të drogave janë me kosto më efektive se sa politikat të cilat e kriminalizojnë përdorimin dhe/ose posedimin e drogave për përdorim personal.

PORTUGALIA



Portugalia në vitin 2001 e dekriminalizoi furnizimin, posedimin dhe përdorimin e të gjitha llojeve të drogave në sasi për dhjetë ditë. Kjo do të thotë se përdorimi dhe posedimi i drogave për përdorim personal tashmë nuk janë vepra penale dhe për ata nuk është paraparë dënimi me burg.

Siç është përmendur në Ligjin për dekriminalizim, ai paraqet **“kornizë juridike për përdorimin e narkotikëve dhe substancave psikotropike, drejt mirëqenies shëndetësore dhe sociale të përdoruesve të këtyre substancave”**.

Ligji është pjesë e modelit më të gjerë portugez në qasjen drejt varësive, që është përmbledhje e masave dhe politikave bazuar mbi shëndetësinë, politikën sociale dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Ligji për dekriminalizim bazohet mbi supozimin se personat të cilët përdorin droga janë qytetarë të cilët kanë nevojë për mbështetje dhe ndihmë nga aspekti shëndetësor dhe social.

Me Ligjin parashihet formimi i Komisionit për bindje, detyra e të cilit është të marre vendim lidhur me dënimet e mundshme në të holla ose administrative, por para së gjithash të bisedojë me personin, për të cilin ka filluar procedurë me sasinë e lejuar të drogave dhe t'i ofrojë opsione për ndihmë dhe trajtim (Greenwald, G. 2009, OSF 2011).

Roli i këtij Komisioni ka rëndësi të madhe për zbatimin e politikës portugeze për droga dhe parqet themelin e tij. Kur ndonjë përdorues i drogave do të kapet nga policia me sasi të palejuara të drogave, ajo i merr të dhënat e tija, e konfiskon drogën jo legale dhe nuk e dërgon në stacion të policisë, por e dërgon deri te komisioni për bindje. Gjatë vizitës së këtij Komisioni bisedohet për arsyet se pse e përdoro drogën, historikun e përdorimit, gjendjen familjare, statusin e punës etj. Qëllimi i Komisionit është që përmes bisedës rreth këtyre temave ta ngrëjë ndërgjegjen te përdoruesi për pasojat e dëmshme nga përdorimi i drogave, duke përfshirë edhe pasojat nga kundërvajtjet e mundshme në të ardhmen, si dhe dënimet, ndërsa nga ana tjetër, ta informojë për të gjitha opsionet e mundshme për ndihmë dhe mjekim dhe ta motivojë dhe dërgojë për mjekim ose në tip tjetër të programeve për ndihmë kur ka mundësi për këtë.

Nëse përdoruesi refuzon ta vizitojë Komisionin, mund t'i caktohet dënim administrativ në mungesën e tij, si dënim me të holla, marrja ose ndalesa për posedim të patentës së shoferit, t'i caktohet masë për kryerjen e ndonjë aktiviteti të dobishëm në komunitet ose t'i ndalohej qasja deri në vend të caktuar (OSF 2011).

Përveç Ligjit për dekriminalizim, modeli portugez bazohet mbi hapjen e një numri të madh të programeve për mjekim, risocializim dhe zvogëlimin e dëmeve nga përdorimi i drogave.


Analizat dhe hulumtimet për modelin portugez të dekriminalizimit të drogave i kanë vërtetuar rezultatet dhe përparësitë si më poshtë:

- Zvogëlimi i përdorimit të drogave te popullata e përgjithshme të moshës 15 – 64 vjet, e veçanërisht te të rinjtë të moshës 15 – 34 vjet;
- Ulja e numrit të përdoruesve problematik të drogave (ata të cilët injektojnë ose janë përdorues afatgjatë të heroinës, kokainës dhe/ose amfetaminave);

- Numri i rritur i paraqitjeve për trajtim, veçanërisht nga ana e përdoruesve të kanabisit;
- Ulja e vdekshmërisë lidhur me përdorimin e drogave prej 369 raste në vitin 1999 në 30 raste në vitin 2016;
- Zvogëlimi i rasteve të HIV te personat të cilët injektojnë droga prej 1.016 raste në vitin 2001 në 21 në vitin 2018;
- Ulja e numrit të burgosurve për veprat lidhur me drogat prej 44 % në vitin 1999 në 15 % në vitin 2018;
- Zvogëlimi i stigmës ndaj personave të cilët përdorin droga dhe sjellja e pranuar e qytetarëve ndaj problemeve lidhur me përdorimin e drogave.

GRAFIKU 1.


Numri i rasteve të vdekjes lidhur me përdorimin e drogave në Portugali për periudhën para dhe gjatë dekriminalizimit të drogave 1999 – 2016



Burimi: SICAD 2020

GRAFIKU 2.

Numri i HIV rasteve lidhur me përdorimin e drogave në Portugali gjatë periudhës së dekriminalizimit të drogave



Burimi: SICAD 2020

H O L A N D A

Holanda njihet në botë për nga politika e saj progresive dhe pragmatike lidhur me drogat, për të cilën ekzistojnë më shumë mite, gjegjësisht të pavërteta, prej asaj se të gjitha drogat janë legale. Holanda është shembull tipik për atë që në teori quhet de fakto dekriminalizim. Te ky tip i dekriminalizimit përdorimi i drogave dhe posedimi i tyre janë vepra penale ose kundërvajtëse, por në praktikë tolerohen, në të vërtetë nuk kryhen sanksione, veçanërisht kur fjala është për posedimin e kanabisit dhe hashashit. Kështu, për posedimin e kanabisit deri në 5 gramë ose 5 rrënjë për përdorim personal, policia nuk do të ngrejë akuzë. Gjithashtu, rasti nuk do të procedohet kur fjala është për posedimin e produkteve të kanabisit për përdorim personal deri në 30 gramë (Opium Act, arts. 2C, 3C, 10(5), Opium Acts Directive, section 'Investigation and prosecution', p. 4).

Posedimi i llojeve tjera të drogës deri në 0,5 gramë po ashtu tolerohet dhe nuk ngrihen akuza.

Policia dhe gjyqësori, para së gjithash, janë orientuar drejt shkatërrimit të tregtisë me sasi të mëdha të drogave dhe prodhimit të drogave, derisa veprat e shpërndarësve të vegjël me sasi të vogla dhe ata të cilët përdorin droga nuk procedohen (shih parimin e praktikës).

Elementi kryesor i politikës moderne holandeze për drogat është Ligji për opium, i miratuar në vitin 1976, qëllimi i të cilit është ndarja e tregut të drogave, gjegjësisht ndarja legale dhe praktike e kanabisit (Lista 2 – drogat e lehta ose kanabisi, rreziqet e të cilave janë të pranueshme) nga drogat tjera (Lista 1 – heroina, kokaina, LSD dhe ekstazet) rreziqet e të cilave nuk janë të pranueshme, si për ata të cilët përdorin droga ashtu edhe për gjithë shoqërinë (OSF 2013, Trimbos Institute 2009). Në vitin 2008 kësaj Liste 1 iu shtuan edhe kërpudhat magjike.

Segment tjetër i rëndësishëm i modelit holandez është hapja e kafeterive (coffee shops). Duke e mundur ekzistimin dhe punën e kafeterive, qëllimi kryesor ishte të ndahet tregu i drogave, që të ndërpritet lidhshmëria e përdorimit të kanabisit me drogat tjera (MacCoun 2011). Me fjalë të tjera, supozohej se ndarja e ofertës së drogave do t'i mbrojtë përdoruesit e kanabisit nga oferta e drogave tjera më të rrezikshme dhe mundësinë për përdorimin e tyre.

PARIMET E PRAKTIKES

Holanda është shembull unik për zbatimin e politikave për drogat. Ka një tolerancë për posedimin e drogave për përdorim personal dhe tolerancë e shitjes së drogave të lehta në kafeteritë, edhe pse nuk është e lejuar me ligj. Në pajtim me parimin e praktikës, Prokuroria publike mund të marre vendim që të mos ngrihet akuzë për vepër lidhur me drogat nëse vlerëson se kjo nuk është në interes publik. Në Udhëzuesin për detektimin e veprave kriminale dhe ngritjen e akuzës, i miratuar në kuadër të Ligjit për opium, janë përmendur prioritetet e mëposhtme për ngritjen e akuzës:

- Prodhimi dhe dhitja e drogave në sasi të mëdha;
- Zbulimi dhe ngritja e akuzës për posedim të drogave për përdorim personal nga Lista 1 (0,5 gramë), si edhe deri në 5 gramë për kanabis gjegjësisht droga nga Lista 2, nuk janë prioritet;
- Për kafeteritë të cilat i plotësojnë kriteret AHOJ-G nuk do të ngritet akuzë nëse i shesin deri në 5 gramë kanabis dhe hashash një personi gjatë një dite (Trimbos Institute 2009).

REZULTATET THELBËSORE TË POLITIKËS HOLANDEZE PËR DROGAT

Politikat holandeze për drogat janë orientuar drejt dekriminalizimit të kanabisit, posedimit dhe përdorimit të drogave, si dhe drejt zvogëlimit të dëmeve nga përdorimi i drogave. Ajo është politikë praktike, racionale dhe humane, e cila jep rezultate.

Ndarja e tregut të kanabisit dhe produktet e tija nga llojet tjera të drogave, dekriminalizimi dhe numri i madh i programeve për kurim, risocializimi dhe zvogëlimi i dëmeve nga përdorimi i drogave i arriti rezultatet e mëposhtme:

- Numri i personave të cilët përdorin droga, para së gjithash heroinë, është në rënie e sipër;
- Injektimi i drogave si mënyrë më e rrezikshme e përdorimit është në minimum dhe vetëm 7% të personave të cilët përdorin narkotikë e bëjnë këtë me injektim;
- Përfshirja e madhe e personave të cilët kërkojnë trajtim për varësi nga drogat (mbi 70%, ndërsa në disa qytete edhe mbi 80% të personave të cilët janë të varur po trajtohen);
- Ulja e vdekshmërisë për shkak të përdorimit të drogave;
- Ulja e shkallës së HIV/AIDS mes personave të cilët injektojnë droga. HIV pothuaj edhe nuk është prezent te kjo popullatë në Holandë, gjegjësisht janë regjistruar vetëm 4 raste të reja në periudhën 2006-2012 dhe nga një ose 2 raste në vitin 2016 dhe 2017.

REKOMANDIME



REKOMANDIME

Politika ekzistuese për drogat në Republikën e Maqedonisë së Veriut nuk është konsistente, nuk i reflekton nevojat reale në shoqëri dhe nuk i respekton të drejtat e njerëzve të cilët përdorin droga ose kanë varësi nga drogat. Për këtë, ka nevojë që:

- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut ta miratojë ndryshimin dhe plotësimin e Kodit penal, me të cilin qartë do të kufizohet posedimi i drogave dhe substancave psikotropike për përdorim personal dhe do të ndalohet ndjekja dhe dënimi i atyre që përdorin droga.
- Ministria e Punëve të Brendshme, Prokuroria publike dhe gjykatat në mënyrë konsekuente t'i zbatojnë dispozitat nga Kodi penal, me të cilat nuk ndalohet posedimi i drogave për përdorim personal.
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë ta fillojë procesin e konsultimit të gjerë për reforma të politikës kombëtare për drogat, ku do të përfshihen institucionet, ekspertët, shoqatat dhe përfaqësues nga ata që përdorin droga, që do të rezultojë me ndryshime të ligjeve, politikave dhe praktikave të institucioneve ndaj përdorimit të drogave. Ky proces duhet të bazohet mbi hulumtimet kombëtare, mbi dëshmi shkencore dhe praktikat më të mira në botë, duke përfshirë edhe përvojat nga Portugalia dhe Holanda.
- Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut të vendose strukturë adekuate për udhëheqjen e politikave kombëtare për drogat.
- Të sigurohet mënyrë afatgjate dhe e qëndrueshme për financimin e programeve për zvogëlimin e dëmeve nga përdorimi i drogave, dhe shërbime tjera që janë të domosdoshme për zbatimin e politikave për drogat bazuar mbi të drejtat e njeriut dhe shëndetin publik. Të hapen programe të reja dhe të avancohen ato ekzistuese për rehabilitimin, risocializimin dhe riintegrimin e personave që përdorin droga.
- Të përmirësohen dhe të avancohen programet ekzistuese për trajtim të varësive nga drogat.

Literatura:

AliUnlu, Tuukka Tammi and Pekka Hakkarainen. Report (9/2020). Drug Decriminalization Policy. Literature Review: Models, Implementation and Outcomes. Finnish institute for health and welfare (THL). Helsinki, Finland.

Benfer, I., Zahnow, R., Barratt, M. J., Maier, L., Winstock, A., & Ferris, J. (2018). The impact of drug policy liberalisation on willingness to seek help for problem drug use: A comparison of 20 countries. *International Journal of Drug Policy*, 56, 162-175. Bergeron.

European Monitoring Centre for Drugs and Drug Addiction (2018a). Cannabis legislation in Europe: An overview. Luxembourg: Office of the European Union.

General-Directorate for Intervention on Addictive Behaviors and Dependencies (SICAD) / Monitoring and Information Directorate (DMI) / Statistics and Research Division (DEI) (2020). STATISTICAL BULLETIN 2018 – Illicit Substances.

Greenwald, G. (2009). Drug decriminalization in Portugal: Lessons for creating fair and successful drug policies. Washington, D.C.: Cato Institute.

International Drug Policy Consortium (2016). A public health approach to drug use in Asia: Principles and practices for decriminalisation. United Kingdom: International Drug Policy Consortium Publication.

MacCoun, R. J. (2011). What can we learn from the Dutch cannabis coffeeshop system? *Addiction*, 106(11), 1899-1910. Maier.

Open Society Foundations (2011). Drug Policy in Portugal. OSF.

Open Society Foundations (2013). Coffee Shops and Compromise. OSF.

Opium Act (arts. 2C, 3C, 10), Opium Acts Directive.

Trimbos Institute (2009). Drug policies in the Netherlands. Ministry of Health, Welfare and Sport.

Boshkova N., Tupançeski N. Dënimi i kundërvajtësve për drogë, politika legjislative dhe praktika gjyqësore, 2014.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Strategjia kombëtare për drogat 2006 – 2012.

Qeveria e Republikës së Maqedonisë. Strategjia kombëtare për drogat 2014 – 2020.

Ministria e Shëndetësisë e R. Maqedonisë, Strategjia kombëtare për drogat e Republikës së Maqedonisë 2006 – 2012. Ministria e Shëndetësisë e R. Maqedonisë, 2006

“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 37/96; 80/99; 04/02; 43/03; 19/04; 81/05; 60/06; 07/08; 139/08; 114/09; 51/11; 135/11; 185/1. Kodi penal, neni 215.

